



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____, Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

VENDIM
Nr. 142, datë 02.04.2021

PËR
CAKTIMIN E GJYQTARËVE PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJEVE GJYQËSORE TË
VEÇANTA NË GJYKATA TË TJERA, TË NDRYSHME NGA AJO KU USHTROJNË
FUNKSIONET NË MËNYRË TË PËRHERSHME

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenet 4/3, 147/1, 147/a, pika 1 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 90/3, 95 e 97/3 të Kodit të Procedurave Administrative, në nenet 2, 89 e 97/3 të ligjit nr.115/2019 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” në vendimin nr.30, datë 14.02.2019 të Këshillit të Lartë të Gjyqësor që miratoi projektvendimin “Për rregullat dhe procedurat e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme” i ndryshuar, në rastet kur skema e delegimit dhe transferimi i përkohshëm janë të pamjaftueshme për t’iu përgjigjur nevojave aktuale të gjykatave, pasi shqyrtoi relacionet dhe propozimin e Komisionit për Zhvillimin e Karrierës si dhe organizoi shortin, në përfundim të tij,

VENDOSI:

I. Të caktojë gjyqtarët për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykatat në nevojë si vijon:

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KRUJË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Rexhep Karaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj; Akuza: “Nenet 223 dhe 238/3 të Kodit Penal”.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, Murat Lleshi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.
3. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Aurel Arapi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: Neni 283/2 dhe 137/1 i Kodit Penal.
4. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, Olti Skrame, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: “Nenet 79/c, 278/1/2 e 301 të Kodit Penal”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR KUKËS

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Sami Ujkashi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria; I pandehur: {...}; Objekti: “Dërgim i çështjes në gjyq”.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tropojë, Aulon Pashaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, çështjen civile me palë paditëse: {...}; Objekti: “Shpallje i zhdukur të personit”.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR PUKË

1. Gjyqtari i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, Luveda Dardha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Pukë, çështjen gjyqwsore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pukë; Objekti: “Kërkesë për gjykimin e procedimit penal nr. 72, viti 2020 në ngarkim të pandehurit {...}akuzuar për veprën penale “Dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130/a/1 i Kodit Penal dhe në ngarkim të pandehurit {...}akuzuar për veprën penale “Dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130/a/3 të Kodit Penal”

GJYKATA E POSACME E SHKALLËS SË PARË PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Korçë, Dritan Hasani, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 298/3, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.

GJYKATA E APELIT DURRËS

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Shkodër, Fuat Vjerdha dhe Astrit Kalaja, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Durrës, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” dhe “Përshtatja e lokalit për përdorim droge”, parashikuar nga nenet 283/1 dhe 285/a të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT SHKODËR

1. Gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Florjan Kalaja, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: Bashkia Shkodër; Objekt: “Fitim i pronësisë me parashkrim fitues”.
2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Durrës, Anita Mici, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse {...} Objekt: “Zgjidhje e menjëhershme e marrëdhënies së punës”.
3. Gjyqtarja e skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, Igerta Hysi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen civile me palë paditëse: {...}; I paditur: {...}Tiranë; Objekti: “Detyrim page”.
4. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Izet Dushaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen penale me të pandehur: {...}; Objekti: “Dërgim i çështjes në gjyq”.
5. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Durrës, Valbon Çekrezi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Shkodër, çështjen gjyqwsore me Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë; I pandehur: {...}; Objekti: “Dërgim i çështjes në gjyq”.

GJYKATA E APELIT VLORË

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi dhe Enton Dhimitri, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me të dënuar: {...}; Akuza: “Moskallëzim krimi”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal (Rishikim vendimi).

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen penale me Kërkues: Prokuroria e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; I pandehur: {...}; Akuza: “Dhunë në familje” parashikuar nga neni 130/a/1 dhe 130/a/3 të Kodit Penal.

GJYKATA E APELIT KORÇË

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; Viktima nga vepra penale: {...}, {...}; Akuza: “Dhunë në familje”.

2. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Zegjine Sollaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen penale me të pandehur: {...}; “Dhunë në familje”.

3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Zegjine Sollaku, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Kërkues: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; Kallëzues: {...}; Person i kallëzuar: {...}; Objekti: Kërkesë për pushimin e çështjes penale nr.1506, datë regjistrimi 31.12.2018. Objekti i shqyrtimit: Kërkesa për përjashtimin e gjyqtar Olsi Xhavella.

4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, Valdete Hoxha, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Korçë, çështjen gjyqësore me Ankues: {...}; Objekti i shqyrtimit: “Kërkesë për përjashtimin e gjyqtares Arta Duka”.

5. Deklarimin e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, të shqyrtimit të kërkesave të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari, si vijon:

1. Kërkesës nr. 178 prot., datë 03.02.2020, të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Paditës i kundërpaditur: {...}; Të paditur kundërpaditës: {...}, {...}, {...}; I Paditur në padi: {...}; I paditur në kundërpadi: {...} Objekti i padisë: “Detyrimin e të paditurve njohje trashëgimtarë”; Objekti i kundërpadisë: “Ndryshimin e vendimit komisioni nr. 570, datë 09.12.1994 dhe vendimit nr. 1410, datë 09.02.1996, të KKKP, Bashkia Korçë”; {...}Shoqëria {...}”, Të paditur: {...}, etj.; Objekti: “Pjesëtim pasuri e paluajtshme”;
2. Kërkesës nr. 822 prot., datë 23.07.2020, të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Paditës: {...}; Të paditur: {...}; Objekti: “Detyrim njohje bashkëpronarë me parashkrim fitues me titull”;
3. Kërkesës nr. 823 prot., datë 23.07.2020 të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Paditës: {...}; I paditur: {...}; Person i tretë: {...}; Objekti: “Deklarimin e zgjidhjes së kontratës së shitblerjes me nr.1876 rep, e 728 kol, datë 06.06.2008”;

4. Kërkesës nr. 833 prot., datë 27.07.2020 të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Paditës{...}; I paditur: {...}; Objekti: “Detyrimin e të paditurit të përmbushë detyrimet që lindin nga kontrata e huasë nr.2156 rep, nr.1202 kol, datë 25.07.2006, për shumën 3.300.000 lekë së bashku me interesat”;
5. Kërkesës nr. 850 prot., datë 29.07.2020 të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Paditës: {...} Të paditur: {...}, {...}; Personi i tretë: {...}; Objekti: “Detyrim për njohje pronar”;
6. Kërkesës nr. 324 prot., datë 26.02.2020 të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Paditës: {...}; I paditur: {...}; Objekti: “Detyrim njohje pronar, etj.”;
7. Kërkesës nr. 212 prot., datë 17.02.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: I pandehur: {...}; Viktimë: {...}; Akuza: “Dhunë në familje”;
8. Kërkesës dërguar me email-in e datës 24.03.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë, regjistruar në KLGJ me nr. 1277/1 prot., datë 24.03.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; i dyshuar{...}; objekti: “Caktim masë sigurimi”;
9. Kërkesës dërguar me email-in e datës 24.03.2021 të Gjykatës së Apelit Korçë, regjistruar në KLGJ me nr. 1277/1 prot., datë 24.03.2021, për caktimin e një gjyqtari në çështjen gjyqësore që iu përket palëve: Kërkues: Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Pogradec; i dyshuar: {...}, objekti: “Caktim masë sigurimi”.

GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Miranda Andoni, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}Akuza: Nenet 134/3, 333/a, 334/1, 287/1/a dhe 287/3 të Kodit Penal.
2. Gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Enton Dhimitri si dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Vlorë, Sokol Ngresi, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: Nenet 298/3, 333/a/1, 333/a/2, 334, 278/2/3, 143/1 të Kodit Penal. Objekti i gjykimit: Shuarja e masës së sigurimit “arrest në shtëpi”.
3. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, Irena Brahimi si dhe gjyqtari i Gjykatës së Apelit Tiranë{...}, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}, etj.; Akuza: Nenet 298/3, 333/a/1, 333/a/2, 334, 278/2/3, 143/1 të Kodit Penal.
4. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Iliba Bezati, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 136/2, 278/1 (2 herë), 28/4, 333/a/2, 334/1 të Kodit Penal”.
5. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Vojsava Osmanaj, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur: {...}; Akuza: “Nenet 283/1, 28/4, 333/a/2, 334/1, 278/1, 236/2 të Kodit Penal”.

6. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, Margarita Buhali si dhe gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Shkodër, Valbona Vata, caktohen në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, çështjen penale me të pandehur{...}; Akuza: “Kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 333/a/1, 140-22 dhe nenet 28/4 e 334/1, 140 dhe nenet 28 e 334/1, 88, dhe nenet 28/4 e 334/1 dhe 278/2 të Kodit Penal”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarëve përkatës të caktuar për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR